# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-440069**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kaos në Kurbin, Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz stadiumin, Laçi përfiton dhe merr 3 pikët |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/13/kaos-ne-kurbin-vllaznia-mbetet-me-10-lojtare-arbitri-zbraz-stadiumin-laci-perfiton-dhe-merr-3-piket54/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 16:25:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 16:15:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 16:14:00 UTC → 13 shtator 2026, 16:16:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9cc0d853e725c7a51b39f0658c9a19e652e41fc72426d1531d4c2f063ee7c900` |
| TEKSTI | `0bcc4648c4c93e61045e345f216fc9be664f0716cadb9ac808ad4d99dc71503c` |
| PAMJA | `fbef698694216d2c442374e5384ca75a3aa9b726aa49b19712aba72004799c81` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9b60d9466883103743cc559d78a3386718d100bac5061f94134d72f92790425c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b8dae6c54853da1d85da2cfc2b078041a9e4d965e832e711de05f684850346bc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9b60d9466883103743cc559d78a3386718d100bac5061f94134d72f92790425c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Kaos në Kurbin, Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz stadiumin, Laçi përfiton dhe merr 3 pikët

13/09/2026 18:15



**Një derbi që kishte gjithçka: gola, përplasje fizike, kartonë të kuq, tribuna të zbrazura dhe një kohë shtesë që vendos rekord në futbollin shqiptar.**

Laçi ka arritur të mposhtë Vllazninë me rezultatin 2-0 në shtëpi, në një 90-minutësh që u zgjat në plot 110 minuta lojë për shkak të tensioneve të vazhdueshme.

**Tension dhe ekuilibër në fraksionin e parë** Ndeshja nisi me ritëm të lartë, teksa Vllaznia rrezikoi që në minutën e parë me një goditje me kokë të Mustës. Teksa shkodranët mbajtën kontrollin e topit në pjesën më të madhe të kohës, kurbinasit u përgjigjën rrezikshëm me kundërsulme. Tensioni i derbit u shfaq qartë rreth minutës së 33-të, kur një përplasje në fushë përfshiu edhe pankinat, duke e detyruar kryesorin Cjapi të ndërpriste lojën për dy minuta dhe të ndëshkonte Nergutin dhe Muratajn me të verdhë. Pjesa e parë u mbyll e bardhë, pavarësisht rasteve nga të dyja kampet.

**Golat, kaosi dhe zbrazja e tribunës**

Pjesa e dytë nisi me ndryshime të shumta, por ishte lëvizja e Laçit ajo që dha rezultat të menjëhershëm. Në minutën e 50-të, një zbritje e shpejtë e Traore përfundoi te Cena, i cili me një gjuajtje të saktë mposhti portierin Avram, duke zhbllokuar shifrat.

Pika e kthesës për keq e Vllaznisë erdhi në minutën e 71-të. Mehmeti u ndëshkua me karton të kuq të drejtpërdrejtë, një vendim që solli protesta të ashpra nga lojtarët shkodranë dhe drejtori sportiv, Vioresin Sinani. Situata degradoi më tej kur një send u hodh nga tribuna përballë. Gjyqtari Kreshnik Cjapi mori një vendim drastik: ndërpreu ndeshjen dhe refuzoi ta rinisë atë pa u boshatisur plotësisht sektori problematik.

**Rinisja fatale dhe shtesa rekord**

Pas rreth 11 minutash ndërprerje, loja rinis në minutën e 88-të me një rivënie anësore për Vllazninë. Por pa kaluar asnjë minutë, kurbinasit goditën sërish. Një harkim i Azizit gjeti Traoren në shtyllën e dytë, i cili dyfishoi shifrat (89').

Për shkak të ndërprerjes së gjatë, tabela e arbitrit të katërt tregoi një shifër të padëgjuar: plot 19 minuta shtesë. Vllaznia u mundua të reagonte, duke pasur një rast flagrant me Balajn i vetëm përballë portierit Guri (90'+4'), por pa sukses. Pas rreth 110 minutash lojë e tension të vazhdueshëm, Laçi festoi një fitore të madhe në shtëpi.

**Top Channel**

## Futboll »


SPORT • KRYESORE





"Ky nuk është më futboll", Ronaldo shpërthen ndaj tifozëve të Al-Taawoun: Të ndalohen përgjithmonë nga stadiumet



Formula 1/ Antonelli është i pandalshëm, italiani triumfon në Madrid dhe sheh titullin kampion t'i afrohet akoma më shumë



Serbia e kishte kapiten, Kosova e mori, Lille i hapi derën, si u shua karriera e Arton Zekajt



Ekskluzive/ "S'kam gjë nga zemra, por...", rrëfimi shokues i Lorenc Trashit pas tmerrit në fushë

ME TË LEXUARAT

Frikë për djalin e Paolo Maldinit, përfshihet në një aksident me makinë pak orë pasi shënoi golin e fitores në Serie A

"Ky nuk është më futboll", Ronaldo shpërthen ndaj tifozëve të Al-Taawoun: Të ndalohen përgjithmonë nga stadiumet

Serbia e kishte kapiten, Kosova e mori, Lille i hapi derën, si u shua karriera e Arton Zekajt

"Higi të gjitha, më pëlqen ngjyra blu"/ Kanet mat ish-futbollisti i

pallatit, bie sipër karrocës me fëmijë
13/09 17:29

kërkon dialog dhe marrëdhënie pa tensione, jo kërcënime për...
13/09 17:06

Madrid dhe sheh titullin kampion t'i afrohet akoma më shumë
13/09 17:04

## Sport »



Fillimi katastrofik i sezonit Valencia shkarkon Drejtorin Sportiv dhe trajnerin
13/09 18:23



'Kurrë mos u dorëzo'/ Maignan jep mesazhe në rrjetet sociale, por shfaqet edhe një bisedë
13/09 17:48



Formula 1/ Antonelli është i pandalshëm, italiani triumfon në Madrid dhe sheh titullin kampion t'i afrohet akoma më shumë
13/09 17:04



MotoGP/ Rikthehet dominimi i Marquez, spanjolli bën dopietë në San Marino dhe merr kryesimin e kampionatit
13/09 16:19



Serbia e kishte kapiten, Kosova e mori, Lille i hapi derën, si u shua karriera e Arton Zekajt
13/09 15:35



Forcë e frikshme, Fernando Torres regjistron rezultatin 970 në makinetën e boksit
13/09 15:15

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Debati me Ramën për 'Territorialen', aktorja tregon përballjen me kryeministrin



Top News-'300 mijë euro ose të pret vdekja'/Kanosi kushëririn me letër, prangoset 56-vjeçari



Top News- 'Si të vrasë shokët e shkollës', adoleshenti pyet ChatGPT...alarmohet FBI



Top News – EuReporter artikull për Veliajn/ Kryebashkiaku: Ende nuk e kam humbur shpresën



Top News- Parandalohet vrasja në Rrogozhinë! 26-vjeçari me kallash shkoi te banesa e një gruaje...



Top News- Nisja e Vitit të Ri Hebre, Kryerabini Yoel Kaplan: Ejani dhe vizitoni Shqipërinë


**Lajme**
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

**Bota**
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

**Sport**
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

**Pop News**
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

**Programe**
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

**Top Channel**
- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria


© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.